



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 23/2010

Prishtinë, 08. 06. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Zef Morina, Fatmir Rexhepi, Mufeta Shini, Qamile Morina dhe Sala Berisha – Shala dhe deputeti i pavarur Naim Rustemi.

Munguan: Mursel Halilj, Adem Grabovci dhe Kaqusha Jashari.

Pjesëmarrës të tjerë: Ekrem Hoxha, kryetar i Bordit të ART-së, Ruzhdi Shehu – MTI, Sanije Berisha – OSBE, Haxhi Gashi – USAID, Besnik Ramadanaj – KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të 01. 06. 2010;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit – ART, për vitin 2009;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese Nr. L-181;
5. Shqyrtimi implementimit të Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 01. 06. 2010

Sala Berisha – Shala – Theksoi se procesverbalet duhet të dërgohen në lekturim, por edhe në redaktim, me qëllim që të arrihet një dokument sa më objektiv.

Qamile Morina – Kërkoi të përfshihet në procesverbal pyetja e saj për ART-në, për çështjes së çekut prej 16 milionë eurosh, i cilësuar si garancion bankar.

Procesverbali i mbledhjes së 01. 06. 2010 u miratua me vërejtjet e cekura më lart.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit – ART, për vitin 2009

Kryetarja – Për ta paraqitur Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit - ART, shtesë për vitin 2009, ia dha fjalën kryetarit të Bordit, z. Ekrem Hoxha.

Ekrem Hoxha - kryetar i Bordit të ART-së – E paraqiti aneksraportin e ART-së për vitin 2009, duke filluar për operatorët ilegalë. Ceku se ART-ja, bazuar në Ligjin për telekomunikacionin dhe në ligjet e tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës, me qëllim të pengimit dhe të ndalimit të veprimtarisë ilegale të operatorëve të palicencuar/paautorizuar në Republikën e Kosovës dhe të krijimit të kushteve normale të operimit të operatorëve të licencuar - autorizuar sipas Ligjit të telekomunikacionit. Javën e tretë të prillit i ka administruar vendimet e dhura dhe e ka autorizuar fillimin e marrjes së veprimeve konkrete që do mundësojnë ndalimin e funksionimit të operatorëve të palicencuar në sektorin e telefonisë mobile në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Aktiviteti në terren për ndalimin e operimit të operatorëve të paautorizuar (MTS, Telenor dhe VIP), përfshirë ndalimin, heqjen e antenave transmetuese, blombimin dhe sekuestrimin e pajisjeve përcjellëse, të operatorëve që nuk posedojnë licencë valide të operimit nga ART-ja, ka filluar në mëngjesin e 23 prillit dhe ka vazhduar deri në mesditën e 24 prillit 2010. Gjatë kuartalit të parë ekipet e specializuara të Departamentit të Menaxhimit të Frekuencave, kanë administruar një punë intensive në terren (janë realizuar mbi 30 matje) të ekipeve mobile të radiomonitorimit. Raporti i matjeve ka konstatuar se në territorin e Kosovës veprojnë 2 operatorë ilegalë të telefonisë mobile: MTS dhe Telenor. Operatori ilegal MTS-së vazhdimisht e ka zgjeruar rrjetin e tij në shumë zona. MTS-ja transmeton kryesisht në brezin zyrtar të operatorit. Vala MTS operon në më shumë se 30 stacione bazë, te gjitha brenda territorit të Republikës së

Kosovës. Telenor-i operon kryesisht në brezin zyrtar të operatorit të licencuar IPKO. Telenor-i operon në më shumë se 6 stacione, brenda territorit të Republikës së Kosovës. Faktet dhe rrethanat e ndërlidhura me faktorin treg dhe shërbimet e ofruara: operatorët e licencuar kanë shtrirë, ndërtuar rrjete telekomunikuese, të cilat kanë arritur mbulueshmëri të lartë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. PTK sh.a, Vala, 98% dhe IPKO Telecommunications LLC, 99%. Penetrimi për kokë banori në fund vitin 2009 ka arritur 70%; Tregu i shërbimeve telekomunikuese në segmentin e telefonisë mobile është liberalizuar, është bërë mjaft konkurrues dhe mbetet i hapur për konkurrencë të mëtutjeshme - operatorë të rrjetit të licencuar dhe operatorë virtualë mobilë të licencuar. Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë oferta të mjaftueshme në dispozicion nga ofruesit e licencuar dhe çmimet e ofruara janë nga më të ulëtat në rajon. Faktori çmim nuk është motivi ose qëllimi i përcaktimit për pranimin e ofertës /zgjedhjen e ofruesit të shërbimit, me faktet dhe me rrethanat e ndërlidhura juridike, sociale dhe ato të sigurisë. Operatorët (MTS & Telenor) nuk kanë poseduar licenca/autorizime përkatëse dhe valide për operim në territorin e Republikës së Kosovës. Pronësia mbi asetet ka qenë dhe mbetet e kontestueshme dhe jo legjitimuar, që e ka pamundësuar edhe grumbullimin e taksave nga autoritetet gjegjëse: ART, ATK etj. Vazhdimi i aktiviteteve komerciale të operatorëve ilegalë e ka sfiduar mandatin ligjor dhe me atë edhe nevojën e ekzistimit të rregullatorit karshi operatorëve të licencuar dhe hapjes/liberalizimit të mëtutjeshëm të tregut të telekomunikacionit, si dhe seriozisht ka e sfiduar interesimin e investitorëve kredibilë në sektor, qoftë në procesin e privatizimit, qoftë në iniciativa të tjera në segmente të caktuara të ofrimit të shërbimeve të telekomunikacionit. Marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat e lartshënuara, Bordi i ART-së, pas konsultimeve aktive me institucionet kompetente vendore dhe me faktorin ndërkombëtar, e ka marrë përsipër ushtrimin e mandatit ligjor dhe aplikimin e ligjshmërisë në sektorin e telekomunikimit. ART-ja ka dhe siguron opinionin e gjerë publik se duhet të jetë e qartë se përpjekjet e operatorëve ilegalë dhe të mbështetësve të tyre, sigurisht nuk do të jenë të frytshme, meqenëse ART-ja me konsekuencë do ta përcjellë çdo aktivitet në këtë fushë dhe me kohë do të ndërmarrë veprime të nevojshme. Duke u përgjigjur për operatorët virtualë, z. Hoxha tha se pas analizës përmbledhëse nga këndvështrimi rregullator, MVNO-ja dhe duke u bazuar në Ligjin për telekomunikacionin (Ligji nr. 2002/7), detyrat dhe përgjegjësitë për sektorin e telekomunikacionit në Kosovë bien mbi MTPT-në dhe mbi ART-në. ART-ja e ka detalizuar kornizën për aktivitetin e MVNO-së (mobile virtual network operators) për të mundësuar qasje rregullatore transparente dhe të parashikueshme, me qëllim të mundësimit të hyrjes së dëshirueshme të MVNO-ve në tregun e Kosovës, duke iu referuar politikave të sektorit të telekomunikacionit të Kosovës si obligim rregullator dhe kërkesës për shprehje të interesit nga PTK sh.a si gatishmëri infrastrukturore dhe interes ekonomik dhe biznesi. Korniza aktuale rregullatore mbulon në masë adekuate aktivitetin e MVNO-së. ART-ja me kornizën rregullatore ka i përvetësuar katër modele të MVNO-ve, ART Ref. nr. 003/08: ‘rishitja’, ‘ofruesi i shërbimeve’, ‘operatori virtual’ (i integruar) dhe ‘brend akteri’. Modeli i zgjedhur nga Dardafon.NET është një model hibrid, që nëpërmjet të taksonomisë së përvetësuar nga ART-ja mund të shikohet si një kombinim i ‘rishitjes’, i ‘ofruesit të shërbimeve’ dhe të ‘brend akterit’. Dardafon.NET ka huazuar pjesë të radiatorit të qasjes dhe të infrastrukturës së rrjetit nga VALA. Gjithashtu ka investuar në pjesë të rëndësishme të infrastrukturës vetjake komplementare të kohës më të re, që ia mundëson asaj t’i

prezantojë me ridisenjim dhe me vlerë të shtuar shërbimet mobile, duke i shfrytëzuar rrjetin e vet të distribuimit dhe fushat adekuate të marketingut. Si rrjedhim e kemi rritjen e konkurrencës, e cila domosdo është shtytëse e inventivitetit nga ana e operatoreve/ofruesve të shërbimeve telekomunikuese dhe e rritjes së mirëqenies ekonomike për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kryetarja – Ua dha fjalën deputetëve për të shtruar pyetje rreth Raportit në diskutim.

Fatmir Rexhepi – Theksoi se e përkrah edhe Aneksraportin me plotësimet e kërkuara nga Komisioni. Po ashtu i përkrahu të gjitha aktivitetet e planifikuara dhe objektivat që i ka shtruar para vetes kjo Agjenci. Shtoi se me këtë punë të mirë dhe të mbarë ky Bord do të vërë në funksion dhe do ta rregullojë këtë sektor, si për të gjithë ata operatorë ilegalë, por edhe për ata virtualë. Në fund tha se e përkrah plotësisht dhe ky Raport duhet të shkojë në Kuvend dhe të aprovohet, në mënyrë që Bordi të punojë mirë dhe ta vazhdojë mandatin deri në fund.

Naim Rrustemi - deputet i pavarur – Theksoi se i ka ngritur disa herë shqetësimet për punën e ART-së në Kuvend, që këto shqetësime të trajtohen para se të vijë Raporti në Kuvend. Pika e parë ka të bëjë me një garanci bankare prej 16.2 milion eurosh, që është ofruar dhe është depozituar në ART prej vitit 2007. Pse në Raport nuk është trajtuar dhe a fiton ndonjë kamatë prej këtij 16.2 milion eurosh ART-ja? Pse nuk është transferuar në mjete *cash* dhe të shkonin në thesarin e MEF-it? Ministri dhe shefi i ART-së e kanë pohuar në vitin 2007 se çeku është në ART. Çështja e dytë, që është ngritur personalisht prej meje dhe prej deputetëve të tjerë, janë marrëdhëniet Dardafone dhe Dardafone.net, një manipulim ordiner i kompanisë, që gabon dhe tenton me qëllim se nuk e njohin ligjin për shoqëri tregtare, ku pronarët nuk janë persona juridikë. Këtë ART-ja duhet ta futë në raport, që kur të vijë në Kuvend, me data të sakta të japë shpjegime se kur është licencuar Dardafone.net-i për NVNO.-në, kur është licencuar Dardafoni për NVNO? A është licencuar Dardafone.net për NVNO, pasi PTK-ja ka bërë marrëveshje me Dardafonin? A ka pasur Dardafone marrëveshje me PTK-ën? Dhe pyetjet e fundit do të ishin: A e ka dhënë lejen ART-ja para se ta jepte licencën që të fillonte PTK-ja, në marrëveshjen me Dardafone.net? Dardafone.net a ka konkurruar në shprehje të interesit për t'u futur në marrëdhënie komerciale me PTK-ën?

Ethem Çeku – Theksoi se për pyetjet e shtruar në takimin e kaluar janë marrë përgjigjet në materialin shtesë, posaçërisht për operatorët ilegalë dhe për ndikimet e tyre. Tha se kemi kërkuar ta kemi një aneks që ky Raport të dërgohet në Kuvend dhe mundësisht ta mbështesin edhe strukturat, qoftë opozitare, për një punë të mirë që duhet të bëhet. Për mua mbetet ende ajo që kemi kërkuar. Unë kam shpresuar se sot do të gjejmë ndonjë informatë rreth çekut prej 16 milionësh, për ta dërguar në Kuvend. Më në fund të sqarohen deputetët, të sqarohet opinioni i gjerë. Me sa shihet këtu nuk është sqaruar ajo çështje. Andaj kemi kërkuar ta kemi të plotë Raportin që ta keni përkrahjen tonë.

Zef Morina – Theksoi se edhe javën e kaluar kemi diskutuar për Kodin shtetëror të telefonisë. Është e vërtetë se kjo është më shumë çështje politike, por ju duhet të përgatitni një udhëtrëgues si duhet të veprojnë Qeveria dhe Ministria, duke pasur

parasysh që Kosova është i vetmi vend me tri kode shtetërore. Ajo që paraqet shqetësim për z. Morina, ishte më tepër numri i operatorëve ilegalë. Numri prej 36 stacioneve është në mbarë Kosovën. Kështu është vetëm për pjesën tjetër të Kosovës, ndërsa për Veriun, në pjesën ku operojnë të gjitha gjërat ilegale, nuk ceket. Çështja e garancisë në bankë është shumë shqetësuese. U bënë më shumë se tre vjet dhe asgjë nuk dihet për të. Në përgjithësi Raporti është i pranueshëm. Mendoj se mund të dërgohet në Kuvend.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se në takimin e kaluar kemi kërkuar disa të dhëna shtesë dhe në shumicën janë përgjigjur. Shtoi se Raporti i plotëson kriteret për të kaluar në seancë plenare të Kuvendit. Kërkoj edhe nga kolegët deputetë të votojnë *Për* që ky Raport të shkojë edhe në Kuvend. Në vija të trasha i ka plotësuar kriteret. Gjithmonë mund të gjejmë vend për plotësime të vogla. Në Komision nuk do të thotë që na kufizohet mundësia t'i ftojmë në çdo kohë dhe në çdo rast ART-në dhe të gjitha agjencitë e tjera të pavarura që t'i raportojnë Komisionit Parlamentar. Në fund tha se e mbështet Raportin dhe e përgëzon Bordin për punën e mirë që e ka bërë.

Kryetarja – Theksoi se Raporti i ART-së ka ardhur me kohë kësaj radhe në Komisionin Parlamentar. Duhet të kihet parasysh se që dy vjet e gjysmë në Komisionin Parlamentar nuk është raportuar në mënyrë aq direkte nga Bordi i mëparshëm i ART-së. Çështja e operatorëve ilegalë në materialin shtesë është cituar mjaft mirë, por ngelet akoma për t'u bërë. Duhet shikuar edhe në Mitrovicë si është gjendja, sepse e kemi nënshkruar një pavarësi në kufijtë e tërë territorit të Kosovës. Edhe pse e di që në atë anë gjendje politike është më e rëndë, por prapë se prapë duhet veprojmë, sepse jemi Rregullator në nivel të Kosovës. Çështja e dytë ajo e operatorëve virtualë dhe çështja e privatizimit, në të cilën ceket se mund të bëhet bartja e licencës, pyeti si është e mundur kjo dhe ku është baza ligjore? Në fund porositi që ART-ja ta bëjë të pamundurën që më gjithë potencialin që ka, por edhe MTPT-ja të mos japin para për kode të huaja shtetërore, por të zgjidhet kjo çështje një herë e përgjithmonë.

Fatmir Rexhepi - Komisionit i takon që për çështjen e PTK-së ta ftojë Drejtorin e Bordit të PTK-së. Lidhur me privatizimin, me ristrukturimin, me organizimin dhe me gjithçka që ka të bëjë me atë kompani publike i takon Bordit të PTK-të vijë dhe të raportojë para deputetëve, për kompetencat të cilat i ka ajo në atë fushë dhe jo ART-së.

Ekrem Hoxha - kryetari Bordit të ART-së – U përgjigj në pyetjet e deputetëve: Raporti që është paraqitur është i vitit 2009. Këto që i keni kërkuar janë për 2010, jo se kemi qenë jotransparent. Kjo nuk ka qenë fshehje e informatës ose kufizim i resurseve, por ka qenë vetëm qasje praktike të raportojmë atë që ka ndodhur më 2009. Garancia bankare, arsyeja pse nuk e keni në shënimet e mia, është sepse s'ka pasur kërkesë për këtë temë. Unë gjatë mbledhjes së kaluar kam raportuar se për këtë temë janë të hapura hetimet nga EULEX-i dhe ART-ja i ka bërë denoncimet lidhur me këtë temë. Për Bordin çështja e garancisë ka qenë temë e panjohur, deri kur është shtruar pyetje parlamentare. Më pas kemi filluar investigimet dhe në arkiv është gjetur garancia. Si autoritet ligjor e kemi iniciuar procedurën e vlerësimit në aspektin legal: se çfarë implikimesh ka në shtetin e Kosovës, se jemi bartës të shtetit për ta ekzekutuar atë letër me vlerë dhe kemi shikuar a ka padi aktive në institucionet gjyqësore dhe a ka pretendime pronësore nga ajo pjesë e

konzorciumit. E dimë se letra me vlerë e ka një kompleksitet për ta tërhequr. Shpresojmë se me këto procedura paralele të hetimeve, është mirë që janë iniciuar, do ta dorëzojmë pranë autoriteteve kompetente, siç është BQK-ja. Në këtë rast me ligj është përcaktuar, se atë letër me vlerë ART-ja nuk është duke e mbajtur pa arsye. Garancia ka validitet deri në janar 2012. Pra shteti nuk rrezikon humbjen e parasë nga ai proces, por rrezikon shumë në aspektin legal, se është procedurë shumë komplekse. Kjo është e vërteta për garancinë dhe çdo gjë tjetër ju siguroj se është spekulim dhe tendencioze. Çështja e Dardafon-it dhe Dardafone.net-it, si Rregullator e kemi shpjeguar Ligjin e telekomunikacionit. Rregullatori e ka mandat ligjor rregullimin e tregut të komunikimit për çdo ofrues të shërbimit nga më i vogli, deri te më i madhi, ka mbikëqyrje të operatorëve të licencuar se a performojnë sipas dispozitave ligjore dhe sipas kërkesave të licencës. Në rastin në fjalë të licencimi i operatorëve virtualë, Rregullatori nuk e ka dhënë licencën. Korniza ligjore e përcakton saktë se kur lëshohet licenca. Ka qenë parakusht të arrihet marrëveshja komerciale ndërmjet palëve të interesit. ART-ja nuk ka të drejtë të ndërhyjë në marrëveshjen e palëve, sepse nuk ka fuqi ndërhyrëse në raportet komerciale ndërmjet palëve. Mund të ndërhyjmë në raporte komerciale ndërmjet palëve vetëm kur shkelen dispozitat e një marrëveshjeje dhe palët hapin procedurë ankimore te ART-ja ose pranë institucioneve gjyqësore, ku ART-ja ftohet si dëshmitare. Bartja është bërë konform ligjit në fuqi dhe konform gjetjeve që i ka pasur Komisioni. Për licencim, për autorizim dhe për monitorim është një komision funksional brenda ART-së i përbërë nga shtatë profesionistë që e kanë parë të rrugës të lejohet të autorizohet bartja. Bartja është autorizuar në dhjetor 2008, ndërsa licencimi i Dardafonit është bërë në qershor 2008, nga Dardafon në Dardafone.net. Ne e kemi bërë një raport publik që është depozituar në organet e hetuesisë. Ne themi se Dardafone.net është vlerë e shtuar e Kosovës. Raportet komerciale ndërmjet palëve në treg janë raporte të pastra komerciale, që i rregullojnë subjektet nënshkruese të marrëveshjes, qoftë njëra palë inicion procedurë ankimore, si gjykatë e shkallës së parë për operatorët e tregut të telekomunikimeve që e marrim në shqyrtim. Ju siguroj se çdo procedurë është respektuar dhe nuk ka asnjë shqetësim se mund të ketë keqpërdorime. ART-ja, falë ndihmës së ofruar nga Ambasada Amerikane dhe USAID-i, ka filluar të merret intensivisht me kodin shtetëror për internet. Ato procedura kanë ngjashmëri në dokumentacion, por jo ngjashmëri të madhe. Procedura kanë qenë ushtrim shumë i mirë. Për ne, edhe sa i përket stafit tonë dhe Kodit shtetëror për internet, janë po aq të rëndësishëm aq sa edhe Kodi shtetëror për telefoninë. E kemi gjithë dokumentacionin e gatshëm në sirtar dhe pritet sinjali nga një zyrë në Uashington, e cila jep leje për qasje. Është pozicioni i MTPT- së dhe i Qeverisë, që ka të drejtë ta paraqesë kërkesën, që të mos rrezikohet me refuzim të menjëhershëm, por të pritët një moment më i besueshëm se do të trajtohet. Në të njëjtën kohë kemi punuar edhe për Kodin shtetëror të telefonisë dhe kemi filluar strategjinë për t'iu qasur ITU-së. Sivjet i kemi organizuar dy konferenca nën patronatin e ITU-së, që në një formë e legjitimon Kosovën në një segment të ITU-së. Ndoshta në muajt e ardhshëm do t'i kemi dy konferenca nën patronatin e ITU-së. Përsëri edhe për Kodin shtetëror sponsorues është Ambasada Amerikane. Faza e dytë për heqjen e operatorëve ilegalë është inkuadruar edhe KFOR-i. Me këmbëngulje kemi kërkuar se nuk do të ketë shtyrje pas 18 qershorit. Kemi kërkuar të jemi të pranishëm në procesin e privatizimit. Pronarin e zgjedh shteti, por ende nuk ka model. Kur të këtë model Rregullatori do ta japë vlerësim.

Zef Morina – Duke u bazuar në nenet 26.2 dhe 26.3 të Ligjit për telekomunikacionin citoi: “Asnjë licencë nuk mund t’i transferohet asnjë personi, duke i përfshirë edhe transferimet në bazë të një procesi të likuidimit nga gjykata, pa miratim paraprak nga ART-ja”. Andaj duke u bazuar në dispozita të cekura më lart, licencat e dhëna nga Vala dhe Ipko-ja, janë në kundërshtim me ligjin. Pyeti në çfarë baze u është dhënë licenca operatorëve D3 dhe Z-mobile?

Ekrem Hoxha - kryetari i Bordit të ART-së – Ligji në fjalë, neni 26 dhe tri nënpikat, e parashohin që pa miratimin e ART-s nuk lejohet bartja. Pra Bordi i ART-së, Komisioni Funkcional me votat e Bordit e ka vlerësuar një aplikacion individual nga pronarët e njëjtë me provat e ofruara me atë dosje të lëndës dhe ka marrë vendim për bartje të licencës. E gjithë dosja e Dardafon-it dhe Dardafone.net është në dorë të hetuesisë dhe pritët ta shqyrtojnë dhe ta zbardhin rastin. Nuk kemi parë në interpretimin tonë që ka ndonjë shkelje procedurale. Janë pretendime që zgjidhen ndërmjet palëve në një strukturë juridike. Qoftë edhe kompani e licencuar, për ato pretendime, ne nuk jemi në dijeni. Si pjesë e hetimeve kemi marrë informacione të kufizuara. Për ne, ligjërisht, kjo temë është e mbyllur në momentin kur e ka votuar Komisioni dhe e ka aprovuar Bordi.

Qamile Morina – Tha se përkundër asaj që nuk po dëshirojmë të kemi qëndrim negativ, na është thënë se aneksi do të dërgohet menjëherë, ndërsa është dorëzuar sot tek deputetët dhe nuk mund të bëhet analizë e mirëfilltë. Shtoi se gjithnjë Raporti mbështetëj ne nene të Ligjit, ndërsa nuk sqarohet se në çka janë bazuar për çështjen e Dardafon-it dhe Dardafone.net. Kërkoj të jepen shpjegime për këtë çështje. Po të ishte hartuar një raport serioz, edhe Komisioni do të ishte i kënaqur. Me aprovimin e tij do të ndikonte të përmirësohet performanca e asaj agjencie ose e Rregullatorit. E vetmja mënyrë që mund të ndikojnë në përmirësimin e performancës është që të kemi rekomandime. Mund të them se kam shumë paqartësi. Do të ishte mirë të shtyhet edhe një herë miratimi i Raportit dhe pastaj t’i japim rekomandimet.

Pas debatit Komisioni, me 5 (pesë) vota Për dhe me 2 (dy) Abstenim, e nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i ART-së për vitin 2009 duke e autorizuar grupin e punës (për monitorimin e zbatimit të Ligjit për telekomunikacion) që për mbledhjen e radhës t’i hartojë rekomandimet në frymën e sugjerimeve që dolën nga diskutimet e anëtarëve të Komisionit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese Nr.L-181

Kryetarja – E paraqiti Raportin e Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe për mbikëqyrjen inspektuese nr. L-181 me propozimamendamente për shqyrtim dhe për miratim.

Amendamenti 1, ndryshohet titulli i Projektligjit; amendamenti 2, ndryshohet neni 2 -

Përkufizimet; amendamenti 3, ndryshohet paragrafi 1 dhe e riformulohet paragrafi 1.1 i nenit 6; amendamenti 4, ndryshohet neni 7; amendamenti 5, teksti i kapitujve III dhe IV i ndërrojnë vendet dhe nenet 8 dhe 9 pësojnë radhitje të re; amendamenti 6, ndryshohet neni 11; amendamenti 7 plotësohet paragrafi 1 i nenit 12; amendamenti 8, plotësohen paragrafët 2,4 dhe 5 të neni 13; amendamenti 9, ndryshohet neni 14; amendamenti 10, plotësohet paragrafi 6 i nenit 18; amendamenti 11, ndërhyhet në pikëpamje tekniko-gjuhësore në paragrafin 1 të nenit 22; amendamenti 12, ndryshohet paragrafi 2 i nenit 24; amendamenti 13, ndryshohen paragrafët e nenit 25; amendamenti 14, ndryshohen paragrafët e nenit 26; amendamenti 15, ndryshohet paragrafi 1 i nenit 27; amendamenti 16, plotësohet paragrafi 1 i nenit 25.

Amendamenti 1

Ruzhdi Shehu - kryeinspektor MTI – Theksoi se me këtë Ligj duhet të themelohet agjencia e inspektoratit dhe e mbikëqyrjes së tregut, sepse më këtë agjenci vihet në funksion më të mirë Inspektorati, duke i marrë parasysh organizimin dhe kompetencat e tij për mbikëqyrjen e tregut. Me këtë agjenci, që do të themelohej me këtë Ligj, nuk do të ketë implikime buxhetore, e arsyetoi propozimin e tij.

Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit – Theksoi se me këtë propozim amendamentesh të kryeinspektorit ky Projektligj do të ketë implikime të mëdha buxhetore, sepse po bëhet fjalë për themelimin e një agjencie. Me rëndësi është ta bëjmë një ligj sa më funksional dhe të arrihet ekzekutueshmëria e vendimit të Inspektoratit, sepse në fund të fundit ky është interes i vetë Inspektoratit.

Sala Berisha Shala – A do të fuqizohet Inspektorati vetëm me ndërrimin e emrit të departamentit duke shtuar se MTI-ja është shndërruar në një agjenciomani. Deklaroi se është kundër themelimit të agjencisë.

Ruzhdi Shehu – kryeinspektor - MTI - Theksoi se me themelimin të Agjencisë Inspektorati do të fuqizohet në çështje ekzekutive.

Fatmir Rexhepi - Shikojeni nenin 9.2 të Projektligjit, sepse aty thuhet shumë qartë se me akt nënligjor Ministria i përcakton organizimin, funksionimin dhe detyrat e Inspektoratit. Kështu që ky nen është mjaftë i qartë dhe nuk ka nevojë për dilema që po shtrohen tani.

Propozimamendamenti i MTI-së nuk u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 13

Ruzhdi Shehu – kryeinspektor - MTI - Theksoi se propozimet të neni 25 janë të harmonizuara me përvojat e vendeve të BE-së dhe aktvendimi duhet të lëshohet nga inspektori sepse është akt individual.

Propozimamendamenti i MTI-së u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 14

Ruzhdi Shehu – kryeinspektor - MTI - Theksoi se masat e gjobave të propozuara janë

plotësisht të harmonizuara me standardet e BE-së.

Propozimamendamenti i MTI-së u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 16

Ruzhdi Shehu - kryeinspektor- MTI - Theksoi se propozimamendamenti është bërë në formën e kërkuar nga Komisioni të ndarja e ndëshkimeve rreth qarkullimit të biznesit. Po ashtu propozimi të neni 37 është në harmoni të plotë me standardet e kërkuara, sepse ky Ligj e rregullon çështjen e inspektorateve të produkteve të ndërtimit.

Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit - Theksoi se propozimi nuk duhet të kalojë si shaka, sepse po ngatërrohen kompetencat në qeverisjen lokale.

Hasan Tahiri - koordinator i Komisionit – I këshilloi të pranishmit se propozim amendamenti lidhur me nenin 38 të Projektligjit, ku propozohet të shfuqizohet Ligji për Inspektoratin e Produkteve të Ndërtimit, nuk duhet përkrahur nga fakti se Ligji për Inspektoratin e Produkteve të Ndërtimit, i ka për objekt: rregullimin, inspektimin e cilësisë së produkteve ndërtimore për inkorporim të përhershëm në ndërtimtari, e cila lëndë dhe kompetencë nuk rregullohen me Projektligjin për Inspektoratin e Tregut dhe për Mbikëqyrjen Inspektuese.

Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit - Theksoi se nuk është pengesë shfuqizimi i atij Ligji, sepse edhe standardi i tregut është objekt i inspektimit dhe si i tillë rregullohet me këtë Ligj.

Ruzhdi Shehu - kryeinspektor - MTI - Theksoi se Komisioni Evropian ka rekomanduar të veprohet në këtë drejtim gjithmonë duke u bazuar në direktivat e produkteve të ndërtimit.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe për Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181 për mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi implementimit të Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian

Kryetarja – Kërkoi nga Komisioni të hartohet Raporti për planin e veprimit të Kuvendit dhe të dorëzohet brenda muajit qershor, sepse është kërkuar nga Kryesia e Kuvendit dhe nga të gjitha komisionet.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se një draft që është dorëzuar nga stafi mbështetës i Komisionit duhet të përpunohet, sepse si i tillë nuk mund të procedohet për Kuvend.

Kryetarja – Sqaroi se ai është një konceptdokument, që ka e hartuar stafi dhe nuk është

Raporti që duhet të dorëzohet, por grupi i punës, i udhëhequr nga deputetja Nerxhivane Dauti, që tash nuk është anëtare e Komisionit, do ta hartojë raportin për implementimin e Planit të veprimit për Raportin e Progresit.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i implementimit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian për mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani